Kush e mohon autencitetin e lëvizjes klimatike në Maqedoni?

Autor: Ivo Bosilkov

Askush nuk është shumë i ri për të bërë ndryshime. Kur në gushtin e 2018, 16-vjeçarja suedeze Greta Thunberg e braktiste shkollën çdo të premte, duke kërkuar politika vendimtare në qeverinë e vendit të saj për të adresuar problemin me ndryshimin e klimës, mbështetja i erdhi vetëm nga prindërit e saj. Dy vjet më vonë, Greta është udhëheqëse e fenomenit global, " Të premtet për të ardhmen "(Fridays for future) , një lëvizje që ka qindra mijëra anëtarë aktivë në të gjithë botën, dhe ka bërë që njerëzimi të shkojë drejt një zgjidhjeje për krizën e klimës më shumë se çdo organizatë tjetër në dekadat e fundit. Edhe emri "krizë klimatike" është rezultat i aktiviteteve të lëvizjes klimatike, e cila ka rritur vetëdijen në nivelin më të lartë që ka qenë ndonjëherë.

Por, për fat të keq, jo edhe te ne. Edhe pse klima para shfaqjes së koronavirusit, dhe sigurisht pas zhdukjes së saj, po bëhet tema numër një në Maqedoninë e Veriut, kjo çështje është akoma një "fshat spanjoll" për shumicën e njerëzve. Për të qenë edhe më tragjike, të rinjtë janë më pak të vetëdijshëm për këtë problem ekzistencial sesa qytetari mesatar. Në javën për të ardhmen midis 20 dhe 27 shtatorit, afro shtatë milion njerëz dolën në rrugë në 185 qytete të botës, shumica e tyre të rinj. Shkupi ka kontribuar në këtë numër me afro qindra protestues, shumë prej tyre të moshuar dhe eko-aktivistë me përvojë.

Si pjesëmarrëse në Marshin për Ardhmërinë në ato ditë, unë u trondita nga shikimet boshe me të cilat të rinjtë vëzhguan procesin nëpër qendrën e qytetit. Gjysmë viti më parë, si një nga themeluesit e degës lokale të quajtur " Të premtet për Ardhmërinë e Shkupit", mendova se nëse ne të moshuarit do të vendosnim shtyllat e kësaj lëvizjeje dhe do t'ua përcjellim mesazhin të rinjve, ata do të na bashkoheshin masivisht dhe do ta merrnin luftën nga ne për ta vazhduar ata. Së bashku me një numër të vogël të entuziastëve të mjedisit, ne kemi bërë fushata në mediat sociale për muaj të tërë dhe kemi kryer veprime guerile në terren për të arritur në mendjet dhe zemrat e të rinjve.

Ajo që supozohej të ishte kulmi i aktivizmit klimatik u shndërrua në një antiklimaks. Të udhëhequr nga supozimi se ata, jeta e të cilëve më së shumti do të preket nga katastrofat e ardhshme, do të kërkojnë me zë të lartë përparësinë e politikave të gjelbërta, ne prisnim që të rinjtë të ishin aq shumë sa të barrikadoheshin para qeverisë në Javën e ardhmërisë. Ne pritëm t'i detyrojnë politikanët që deri në fund të dekadës t'i hapin rrugë emetimit të dioksidit të karbonit deri në shkallën zero dhe ta shndërrojnë sistemin e energjisë në burime të rinovueshme, të prezantojnë masa kundër ndotjes industriale dhe trafikut, të cilat në një afat të

shkurtër shkaktojnë sëmundje vdekjeprurëse për bashkëmoshatarët e tyre dhe shokët e klasës, ndërsa në planin afatgjatë do të krijojnë ferr në planetin e vetëm që kemi.

U gabuar. Të rinjtë thjesht nuk u shfaqën.

Për dështimet e çdo lëvizjeje shoqërore, së pari duhet të shikohet nga brenda. Sigurisht, mungesa e përvojës, angazhimet e punës së anëtarëve të saj që po humbin kohë për grante në mënyrë vullnetare, dhe vlerësimet e gabuara strategjike kanë qenë pjesë e rezultatit përfundimtar të aktivizmit. Sidoqoftë, ekzistojnë edhe faktorë të jashtëm, më të rëndësishmit nga të cilët janë mosinformimi dhe apatia. Shumë prej atyre që supozohet të jenë pionierë të klimës nuk dinë as për problemin, sepse ata thjesht nuk dinë se ku mund të marrin informacionin rreth tij. Sistemi arsimor i shkatërruar nuk e trajton aspak këtë problematikë dhe prindërit e tyre janë shumë të zënë për t'i edukuar fëmijët e tyre në frymën e ekologjisë, pastaj ku i dihet a e kanë dhe ato vetë këtë lloj edukimi.

Të tjerët, mes bashkëmoshatarëve të tyre, e dinë për problemin, por e shohin aktivizmin politik "Fridays For Future" si humbje kohe, e cila mund të shpenzohet shumë më mirë me Fortnite, ose në Instagram, ose thjesht për argëtim. Po, ndryshimi i klimës është problem, por çfarë mund të bëjë një person për të ndryshuar diçka? Politikanët nuk kanë vesh për të dëgjuar. Ka më shumë kuptim ta kalosh rininë në bukuritë e jetës, në vend të këmbënguljes donkishoteske për të pamundurën.

Këto janë dështime thelbësore të sistemit, por jo të papritura kur vetë ai sistem prodhon vazhdimisht krizën e klimës. Sidoqoftë, të painformuarit dhe apatikët në çdo luftë për një botë më të mirë në fund janë tërhequr nga një masë kritike e cila me pasionin e saj vendosi të bëhet pararoja e asaj lufte. Por përkundrazi, ajo masë kritike sot është kundër lëvizjes së klimës dhe është një pengesë që i ndalon të tjerët të bashkohen.

Për këtë kategori, ndryshimi i klimës është shpikje e disa qarqeve të fuqishme që thjesht duan t'ua marrin makinat dhe motorët e tyre, të përfitojnë nga e ashtuquajtura reformë energjetike dhe me forcë t'i detyrojnë kombe të ndryshme të bashkëpunojnë, edhe pse marrëdhënia e tyre natyrore duhet të jetë armiqësore. Ata nuk besojnë se që nga vitet e tetëdhjeta e deri më sot, Arktiku ka humbur gati 15 përqind të sipërfaqes së tij të akullt (territor me madhësinë e Teksasit) për shkak të ngrohjes globale. Për ta, rritja globale e katastrofave natyrore, siç janë uraganet dhe shirat e rrëmbyeshëm janë një rastësi, ndërsa thatësirat, gjë kalimtare. Dëshmi e mjaftueshme e gjithë kësaj është se ndonjëherë edhe në verë mund të bjerë shi, ndërsa dimrat të jenë akoma më të ftohtë.

Qëndrime të tilla janë shpeshtuar me paraqitjen e Greta Thunberg. Suksesi krijon gjithmonë armiq, si nga zilia ashtu edhe nga dyshimi për vlerën e vërtetë të atij që e arrin. Sot, kjo adoleshente e vogël quhet kukull autike e rendit të ri botëror, një profete e rreme, një

manipuluese e pandershme. Për ta, fakti që Greta është zëri i lëvizjes klimatike është prova më e madhe që i gjithë problemi është një komplot i madh.

Në epokën dixhitale, konflikti midis ideve zhvillohet në arenën e informacionit. Për shkak të gamës së saj të gjerë dhe aksesit, të gjithë kanë një zë të barabartë atje, dhe rregulli i vetëm është se nuk ka rregulla. Në arenën e informacionit, nuk zgjidhen mjetet për të përfituar në konfliktin ideologjik, dhe për këtë arsye diskreditimi personal është një mjet i fuqishëm në kushte të korrupsionit të gjerë dhe diktat i motiveve financiare. Pra, nëse keni arritur të bindni ndjekësit se personi që promovon një ide është i korruptuar, atëherë keni arritur të diskreditoni idenë.

Në kontekstin e informacionit kontradiktor që i jep kuptim termit "post e vërteta", autenciteti është gjëja më e vlerësuar. Këtu qëndron suksesi fillestar i Gretës, sepse është e vështirë të njohësh një qëllim të fshehtë në pikëpamjet e një fëmije të zakonshëm. Por mosha e saj është gjithashtu arsyeja e sulmeve të rënda që ajo pëson. Për shumë njerëz, kjo do të thotë se ajo ka një makineri që i rri prapa dhe që e ndihmon në të folurit në publik, e cila lobon të shfaqet në ngjarje të rëndësishme dhe të takojë njerëz të rëndësishëm.

Pyetja kryesore për ta bërë në këtë moment është një e vetme. Edhe?

Çka do të thotë kjo?

A do të thotë që Greta nuk beson në rrezikun që na kanoset? A do të thotë se rreziku në të vërtet nuk ekziston?

Për të arritur tek e vërteta, duhet të rishqyrtojmë nëse ajo që besojmë në fshehtësi, dëshirojmë të jetë e vërtetë. Kjo është aftësia kryesore e të menduarit kritik. Kur jemi të ekspozuar ndaj informacionit që aktivizon shqisat tona, atëherë karakteri ose mënyra e të folurit e dikujt mund të jenë antipatike për ne. Këtu fillon të ndërtojmë një predispozitë për një interpretim negativ të të gjitha veprimtarive të këtij personazhi, dhe ai predispozicion ndiqet nga mendimet tona për të gjitha veprimet e tij të mëtejshme. E gjithë kjo përshtatet në perceptimin tonë të përgjithshëm të këtij karakteri, i cili duhet të jetë i qëndrueshëm, sepse përndryshe do të jemi të hutuar dhe të pasigurt, ndërsa askush nuk dëshiron të ndihet në atë mënyrë.

Ai që e quajti Greta Thunbergun si jo autentike, padyshim që do të ekspozohet më shumë ndaj mohimit të ndryshimit të klimës. Sidoqoftë, drejtimi i arsyetimit të tij në të vërtetë është i kundërt. Ai thellësisht dëshiron që kriza e klimës të jetë e pavërtetë, dhe për këtë arsye u jep rëndësi të gjitha indikacioneve të mundshme që Greta nuk është autentike. Ai e dëshiron këtë, sepse është shumë më e lehtë të bësh gjumë natën nëse beson se bota është e pandryshueshme, se nuk ka asnjë problem të kësaj përmase, se gjithçka do të jetë mirë. Por nuk është kështu. Konsensusi shkencor është se nëse tejkalohet pika e ngrohjes globale mbi 1.5 shkallë, do të fillojë një reagim zinxhir, i cili në gjysmën e dytë të shekullit 21 do të rezultojë në dhjetëra, ndoshta qindar, miliona vdekje.

Mentaliteti anti-shkencor çon në shkatërrim. Ne i detyrohemi shkencës për gjithçka që jemi si civilizim. Ashtu sikur klimatologët parashikojnë zhvillimin e ngjarjeve, edhe psikologjia dhe sociologjia tregojnë për pasigurinë e këtyre proceseve individuale dhe kolektive në qasjen e tyre ndaj Greta Thunbergut, “Fridays For Future” si dhe ndryshimeve klimatike. Shkencës duhet t'i besohet, është një nga porositë kryesore të suedezes.

Kjo është arsyeja pse njohja e mediave dhe informacionit është një premisë themelore në epokën moderne. Nëse të rinjtë janë në gjendje t'i rezistojnë reagimit instinktiv ndaj mesazheve të tmerrshme të ngrohjes globale, nëse kontrollojnë mekanizmin mbrojtës kundër informacionit të pakëndshëm, atëherë ata shpejt do të shohin se sulmet ndaj lëvizjes së klimës vijnë nga ndërmarrje të mëdha nafte dhe nga lobi i tyre. Vetëm ata kanë interes për gjendjen status quo.

Por ata do të jenë të aftë, vetëm atëherë kur ne t’i aftësojmë. Të gjithë institucionet sociale duhet të përfshihen në emancipimin e të rinjve. Ndryshimi i sistemit është i nevojshëm, jo ndryshimi i klimës.